



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Perandori Justinian 71 - Prishtinë/Pristina
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NE MBROJTJE TE PRONËS PRIVATE - PROTECTING PRIVATE PROPERTY - ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

Nr. i ref.: 01024/16/ /ks

Data: 05/10/2016

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-079 (të ndryshuar) për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale; në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 12 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 18 paragrafi 3, nenit 8 dhe 19 paragrafi 1 dhe 2, nenit 20 paragrafi 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 07/2010, për emërimin e nëpunësve civilë, U.D. Zëvendës Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronës nxjerr:

V E N D I M

- I. Shpresa Sogojeva**, e cila është në marrëdhënie pune në AKP si nëpunëse e karrierës ngritet në pozitën, **Menaxher i Personelit**, Divizioni i Burimeve Njerëzore prej datës 06 Tetor 2016.
- II.** E lartpërmendura si në pikën **I** të këtij Vendimi, nuk i nënshtrohet punës provuese pasi që tani më ajo ka përfunduar atë me sukses.
- III.** E lartpërmendura pas pranimit të këtij Vendimi është e obliguar të paraqitet në Njësinë e Burimeve Njerëzore, me qëllim të nënshkrimit të akt emërimit.

A r s y e t i m

Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil, me qëllim të zbatimit të konkursit të brendshëm të shpallur më 06/09/2016, në ueb faqen e brendshme të AKP-së, dhe duke vepruar në përputhje me parimet themelore për pranim në shërbimin civil, si dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së rekrutimit, në mesin e kandidatëve më të suksesshëm për pozitën - **Menaxher i Personelit** e ka përzgjedhur dhe ka propozuar kandidaten **Shpresa Sogojeva**.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe duke vepruar konform nenit 4 paragrafi 2 të Rregullores nr.07/2010, për emërimin e nëpunësve civilë, Zyra e Burimeve Njerëzore e ka aprovuar propozimin e Komisionit përzgjedhës, dhe të njëjtin pastaj ia ka paraqitur Drejtorit Ekzekutiv për miratim përfundimtar.

Duke u bazuar në faktet e paraqitura si më lartë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara në preambulë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.


Florije Kika
U.D. Zëvendës Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Pronës

Vendimi u dërgohet:

- Shpresa Sogojeva,
- Njësisë së Burimeve Njerëzore

